



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM

Nr. 13, Datë 28.10.2020

**PËR EMËRIMIN E AUDITIT TEKNICIEN PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË
DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 19 pika 1 germa “n” dhe pika 2, neni 61 pika 2 dhe pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC, pasi shqyrtoi propozimet për auditët teknicienë dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N

Referuar nenit 61, pika 2 dhe pika 3 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbikëqyr procesin e hartimit të listave duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 30 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me vendim dy auditë teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Të drejtën e propozimit për auditët teknicienë e kanë respektivisht Komisioneri dhe Nënkomisioneri. Auditët teknicienë ndihmohen nga jo më shumë se 2 ndihmësa, të cilët caktohen nga KQZ-ja me propozimin e auditit.

Auditët teknicienë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të kenë arsim universitar dhe eksperiencë në fushën e zgjedhjeve;
- b) Të ketë njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile;
- c) Të jenë të padënuar penalisht, së bashku me jetëshkrimet e tyre.



Të drejtat, detyrat dhe kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet KQZ-së dhe auditeve teknicienë përcaktohen në udhëzimin e KQZ-së nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ.

Referuar nenit 61 pika 2 dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri cakton si audit teknicien zj. Brisela Mehmetllari.

Kohëzgjatja e kontratës së zj. Brisela Mehmetllari me KQZ-në, do të jetë nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar, 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Duke pasur parasysh ngarkesën e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës duhet të shpërblehet me 120 mijë lekë për të gjithë kohën e angazhimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1 germa “n” dhe pika 2, dhe nenit 61 pika 2 dhe pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S A:

- 1- Të emëroj audit teknicien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, zj. Brisela Mehmetllari, caktuar nga Komisioneri i KQZ-së.
- 2- Të caktojë masën e shpërblimit në vlerën 120 mijë lekë për auditin teknicien për gjithë periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
- 3- Ngarkohet auditi teknicien të propozojë ndihmësat brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 5- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI

